



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**Nr. 4/2018, Regjistër (JR)
Datë 23.05.2018**

**Vendim nr. 3
Datë 17.07.2018**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Luan Daci	Kryesues
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ardian Hajdari	Anëtar
Sokol Çomo	Anëtar

mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 17.07.2018, ditën e martë, ora 10:00, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 04/2018 (JR), datë 23.05.2018, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit:

ANKUES:

FATOS LULO, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nr. 1137 rep., nr. 324 kol., datë 02.03.2018 nga Avokat Ardian Visha, me nr. licence 3525.

OBJEKTI I ANKIMIT:

Ndryshimin e vendimit nr. 12, datë 23.03.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Fatos Lulo.

BAZA LIGJORE E ANKIMIT:

Neni 62 e vijues, neni 66/b i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoi relatimin e çështjes nga gjyqtare relatores Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I.

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 12, datë 23.03.2018, ka vendosur:
 - *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Fatos Lulo, gjyqtar pranë Gjykatës Kushtetuese.*
 - *Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit 84/2016.*
 - *Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
2. Kundër vendimit nr. 12, datë 23.03.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet avokatit të tij, Ardian Visha, i pajisur me prokurë të përgjithshme nr. 1137 rep., nr. 324 kol., datë 02.03.2018, me nr. licence 3525, i cili kërkon ndryshimin e vendimit të mësipërm dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Fatos Lulo, duke parashtruar këto shkaqe:
 - 2.1 Vendimi i Komisionit është në kundërshtim me ligjin nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim ligji nr. 76/2016) dhe nr. 84/2016, pasi Komisioni e përfundoi procesin e rivlerësimit për subjektin Fatos Lulo vetëm për një kriter të pasurisë, duke mos vendosur për kriteret e vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional dhe kjo përbën një vendim të ndërmjetëm të Komisionit që nuk i është njoftuar subjektit.
 - 2.2 Nuk janë zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe parimet e tij. Vendimi i Komisionit është konfuz, i paqartë, me përsëritje të vazhdueshme, me mungesë analize juridike të fakteve, trajtim të njëanshëm të provave dhe shprehje kontradiktore të paqarta, se vendimi nuk është i arsyetuar dhe nuk përmban elementet thelbësore të vendimit.
 - 2.3 Komisioni ka tejkaluar tagrat dhe kompetencat, pasi nuk duhet të hetojë për një periudhë në të cilën subjekti nuk ka qenë gjyqtar, dhe as subjekt i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim ligji nr. 9049/2003). Komisioni në hetimin e vet administrativ, si dhe në vendimin e tij ka tejkaluar tagrat dhe kompetencat e tij që i janë ngarkuar nga ligji, gjë e cila ka sjellë si pasojë cenimin e parimit të ligjshmërisë. Subjekti duhet të ishte hetuar dhe t’i bëhej rivlerësimi që nga fillimi i

ushtrimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë e deri më sot, pra nga data 13.02.2006, dhe jo përpara kësaj date.

Subjekti i rivlerësimit duhet të hetohet vetëm për 7 vitet e fundit, pra 2011-2017, e jo për të gjithë kohën, për shkak se ka kaluar në hetim të thelluar administrativ nga ILDKP-ja në vitin 2011. Subjekti Fatos Lulo duke qenë me detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, ka qenë subjekt deklarues dhe është ushtruar kontroll i thelluar ndaj tij, ku janë verifikuar të gjitha deklaratimet që janë dhe sot. Subjekti ka ushtruar përsëri detyrën e tij si gjyqtar pas këtij kontrolli, fakt i cili tregon se ka pasur deklaratim të saktë, përderisa ai ka vazhduar detyrën.

2.4 Nuk janë trajtuar provat në mënyrë të barabartë, nuk janë marrë parasysh vendimet e gjykatës për regjistrimin e tij si person fizik, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, por janë trajtuar në mënyrë të njëanshme shkresat e Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT) Tiranë nr. 77111/1, datë 23.01.2017 dhe shkresa e DRT Tiranë nr. 4831/1 prot., datë 27.01.2017, si dhe shkresa e DRT Tiranë nr. 66148/1 prot., datë 19.12.2017.

2.5 Subjekti nuk është vënë në dijeni për pamjaftueshmëri të provave, veçse në momentin e komunikimit të raportit përfundimtar.

2.6 Nuk është përcaktuar një metodologji për përcaktimin e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit.

2.7 ILDKPKI-ja me konkluzionet e saj ka dalë jashtë tagrave që i parashikon ligji, ku është shprehur që subjekti ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, gjë e cila është jashtë kriterëve që parashikon neni 33 i ligjit 84/2016.

2.8 Komisioni ka gabuar kur ka interpretuar se znj. D.L duhet të ishte aksionere ose të kishte ndërtuar një ortakëri të thjeshtë me shoqërinë “{***}” SHPK, kjo në zbatim edhe të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9901/2008).

2.9 Është i gabuar interpretimi i Komisionit, sa i takon burimit të të ardhurave dhe ligjshmërisë së tyre nga dy kontratat e sipërmarrjes, përkatësisht kontrata nr. 7740 rep., nr. 2916 kol, datë 04.12.2000 dhe kontrata nr. 1418 rep., nr. 523 kol., datë 27.02.2006.

2.10 Komisioni është treguar i njëanshëm në vlerësimin e provave kur ka interpretuar se znj. D.L nuk ka përfituar të ardhura sipas kontratave të sipërmarrjes të vitit 2000 dhe 2006 sipas pikës 2.9 më sipër, pasi ato nuk janë të pasqyruara në bilancet e shoqërisë, e për pasojë duke mos marrë në konsideratë bilancet e viteve 2004, 2005, 2006 dhe 2007 të vënë në dispozicion nga subjekti. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë bilancet e shoqërisë “{***}” SHPK për vitet 2011-2016. Për pasojë, Komisioni pa të drejtë ka arsyetuar të mos marrë në konsideratë këto prova për justifikimin e të ardhurave të ligjshme të znj. D.L.

II.

II/1. Çështje procedurale:

3. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me ankimin, ka paraqitur disa akte shkresore, të cilat ka kërkuar që të merren në cilësinë e provës. Konkretisht, janë paraqitur: kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. 3385 rep., nr. 1552 kol., datë 16.05.2012; certifikatë njohje kontributi, lëshuar nga “{***}” ({***}), më datë 06.10.1999; vërtetim i datës 05.04.2018 nga zyra ligjore “{***}”, Ontario, Kanada, mbi ekzistencën ose jo të

interesave mbi pasuri të paluajtshme në Ontario, Kanada. Për sa u përket këtyre akteve, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të mos i marrë si provë në gjykim, pasi ato nuk plotësonin kërkesat e nenit 47 të ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 49/2012) dhe të nenit 49, pika 6, germat “a”, “b” dhe “d” të ligjit 84/2016. Ky vendim i ndërmjetëm u mor për shkak se provat e kërkuara nga subjekti mund të ishin paraqitur gjatë shqyrtimit në procesin e vlerësimit në Komision dhe subjekti nuk parashtroi në ankim asnjë shkak të ligjshëm për mosparaqitjen e tyre në kohë pranë Komisionit. Gjithashtu, këto prova të reja u konsideruan si të panevojshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes, pasi faktet që kërkohej të provoheshin ishin të parëndësishëm për vendimmarrjen, por edhe nëse konsideroheshin të vërteta, nuk ndikonin në marrjen e vendimit.

4. Për sa u përket akteve të sjella me parashtrimet e subjektit, para shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, ato nuk u pranuan, pasi nuk u paraqitën në përputhje me parashikimet ligjore, përkatësisht neni 49/2 i ligjit 49/2012 që parashikon: *Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 (pesë) ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim*, por në asnjë rast kjo dispozitë nuk parashikon paraqitjen e provave të reja.
5. Në ankim është kërkuar shqyrtimi i çështjes në seancë publike. Lidhur me këtë kërkesë, trupi gjykues vlerësoi se ajo nuk mbështetej në kërkesat e nenit 51 të ligjit 49/2012, e për pasojë vendosi të mos kalojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve.

II/2. Rrethanat e çështjes:

Nga shqyrtimi në tërësi i të gjithave shkaqeve të parashtruara në ankim mbi bazën e dokumentacionit, mbi të cilin Komisioni ka bërë vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Fatos Lulo, trupi gjykues konstaton se:

6. Subjekti i rivlerësimit Fatos Lulo, për shkak të funksionit të tij si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, referuar nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, si dhe nenit 4, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, është subjekt i rivlerësimit (*ex officio*) me përparësi.
7. Komisioni ka filluar hetimin administrativ për të tria kriteret e vlerësimit dhe ka vazhduar hetim të thellë dhe të gjithanshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, mbi bazën e të cilit ka marrë vendimin nr. 12, datë 23.03.2018.
8. Subjekti i rivlerësimit Fatos Lulo është bërë “subjekt deklarues pasurie” që nga viti 2004 dhe ka vazhduar deri në deklarimin e pasurisë së rivlerësimit (*vetting*) në vitin 2017, me numër indeks 4175, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, në të cilën ka deklaruar sa më poshtë.

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me pasurinë:

- a- Apartament banimi + depo + sipërfaqe e azhurnuar 112 m² + 15 m² + 2.5 m², rr. “{***}”, fituar me kontratë sipërmarrjeje, datë 08.12.2001 dhe kontratë shitjeje datë 24.03.2014. Me të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit si avokat dhe paga e bashkëshortes. Vlera 50000 dollarë amerikanë (në vijim USD), plus shpenzime mobilimi, barabartë me 9.300.000 lekë. Pjesa takuese 50%.
- b- Njësi nr. 20 (e konsideruar zyrë), me sip. 172 m², e ndodhur në godinën nr. {***}, Rruga {***}, fituar me kontratë dhurimi, datë 06.12.2011. Vlera 0 (zero) lek. Pjesa takuese 100%
- c- Zyrë (ish-avokatie) në rr. “{***}”, me sipërfaqe 74 m², në përdorim me të drejtë blerjeje, në shumën 13.800.000 lekë. Vlera 0 (zero) lek. Pjesa takuese 0 (zero)%.
- ç- Llogaria e pagës në “Credins Bank”. Vlera 32.242,45 lekë. Pjesa takuese 100%.
- d- Kartë krediti “Visa Classic” në “Credins Bank”. Pjesa takuese 100%.
- dh- Kartë krediti në “Raiffeisen Bank”. Pjesa takuese 100%.

Deklarimi i të ardhurave:

- a- Të ardhura nga puna si jurist në organe të ndryshme shtetërore në Tiranë, sipas dinamikës së librezës së punës. Shuma: 90.000 lekë.
- b- Të ardhura nga aktiviteti privat me profesion avokat, me fillim vitin 1995-1999 e më pas në vitet 2002-2005. Shuma: 10.500.000 lekë.
- c- Dhurim prej 100.000 USD me kontratën nr. 1369 rep., dhe nr. 547 kol., datë 21.08.2008.
- ç- Të ardhura nga puna si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, në vitet 2006-2013. Shuma: 11.938.448 lekë.
- d- Të ardhura nga puna si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, nga viti 2013 deri në janar 2017. Shuma: 6.997.637 lekë.

Deklarimi i personave të lidhur/ bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. R.. Bashkëshortja, znj. R.L, ka nënshkruar autorizimin e personit të lidhur dhe ka deklaruar se disponon pasuri veçmas, si më poshtë:

Deklarimi i pasurive:

- a- Apartament banimi + depo, sipërfaqe e azhurnuar 112 m² + 15 m² + 2.5 m², rr. “{***}”, fituar me kontratë sipërmarrjeje datë 08.12.2001 dhe kontratë shitjeje datë 24.03.2014. Me të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortit si avokat dhe paga. Vlera: 50.000 USD, plus shpenzime mobilimi, e barabartë me 9.300.000 lekë. Pjesa takuese 50%.
- b- Apartament banimi i privatizuar në vitin 1993 nga shteti, në rr. “{***}”, 1+1, me sipërfaqe 68.54 m², Tiranë, në bashkëpronësi me katër anëtarë të familjes së saj gjatë vajzërisë. Vlera: 17.440 lekë. Pjesa takuese 20%.

Deklarimi i të ardhurave:

- a- Të ardhura nga puna për vitet 1994 deri në 1998, si dhe për vitet 2002-2008, si e punësuar në Akademinë e Shkencave, Qendra e Studimeve Gjeografike, Tiranë.

Shuma: 5.997.600 lekë.

- b- Të ardhura nga puna për vitet 2014-2015, si mësuese në shkollën “{***}”, Tiranë. Shuma: 270.000 lekë.
- c- Të ardhura nga shitja e apartament banimi 1 + 1, rr. “{***}”, me sipërfaqe 68.54 m². Shuma: 5.000 USD.

Deklarimi i personave të lidhur/ djalit të subjektit të rivlerësimit, E.L:

- a- Depozitë në “Credins Bank”. Të ardhura nga familja. Vlera: 100.000 lekë. Pjesa takuese 100%.

Deklarimi i personave të lidhur/ djalit të subjektit të rivlerësimit, E.L:

- a- Depozitë në “Credins Bank”. Të ardhura nga familja. Vlera: 100.000 lekë. Pjesa takuese 100%.

Deklarimi shtesë i deklaratës së pasurisë (vetting) 2017:

Subjekti i rivlerësimit Fatos Lulo i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë (vetting) edhe një deklaratë, e cila në përmbajtjen e saj citohet më poshtë:

Unë, Fatos Y. Lulo, me detyrë anëtar i Gjykatës Kushtetuese, duke qenë se jam subjekt i deklaratës së pasurisë, si dhe në mbështetje të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë", shoh të nevojshme të sqaroj nëpërmjet këtij deklarami, sa më poshtë vijon:

Në deklaratimin tim të parë, që mban datën 27.11.2004, si rezultat i emërimit tim si anëtar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit:

- 1. në formularin A-1, faqe 4, te pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to, kam deklaruar apartament banimi me sipërfaqen dhe vlerën përkatëse në Toronto, Kanada, të pahipotekuar;*
- 2. në formularin A-5, faqe 8, te pjesa likuiditete, kam deklaruar depozitë jashtë vendit 400.000 dollarë kanadezë në Toronto, Kanada;*
- 3. në formularin A-8, te detyrime financiare ndaj..., kam deklaruar marrjen hua të shumës 480.000 dollarë amerikanë motrës sime.*

Në deklaratimin tim periodik, që mban datën 27.03.2006, si rezultat i emërimit tim si anëtar i Gjykatës së Lartë:

- 1. në faqen 3 të tij kam deklaruar shitje apartamenti në Toronto, Kanada, si edhe shumën përkatëse;*
- 2. në faqen 5 të tij kam deklaruar shlyerjen e huas 480.000 dollarë amerikanë, dhënë nga motra ime.*

Sa më sipër, sqaroj se kam dy shtetësi, atë shqiptare dhe atë kanadeze. Në vitin 2004, vit që përkon me deklaratimin tim të parë, unë kam qenë rezident në të dyja vendet (vërtetohet nëpërmjet taksave të shtetit kanadez) dhe njëkohësisht, së bashku me motrën time, D.L, biznesmene në fushën e ndërtimit në një nga shoqëritë me emër në Shqipëri, menduam të zhvillonim edhe në Kanada biznes së bashku. Për këtë, motra ime D. më dha hua në CASH shumën 480.000 dollarë amerikanë (shiko kontratën e huas, me nr. 5120 rep., datë 04.09.2000).

Formulari i deklarimit të parë, mbushur nga unë, datë 27.11.2004, pasqyron mundësinë e blerjes së një apartamenti me ekstremitetet përkatëse në Toronto, pasi unë isha në tratativa për blerjen e tij me agjenci imobiliare, prandaj në formular është shënuar i pahipotekuar, për vetë faktin se akoma nuk ishte blerë.

Për sa më sipër, në pikën 2, nga shuma që unë kisha në dispozicion prej 480.000 dollarësh amerikanë, mendoja të hapja një llogari në bankat në Kanada, në shumën 400.000 dollarësh kanadezë. Ky fakt është më se i vërtetë, pasi unë nuk kam vënë asnjë numër llogarie për këtë shumë, pasi nuk ekzistonte të qe bërë kjo transfertë. Duke qenë se unë s'po ndërmerrja asnjë veprim në lëvrimin e shumës për blerjen e apartamentit, agjencia imobiliare ku kisha bërë prenotimin, kreu shitjen e saj në vlerën që unë e kam pasqyruar në deklarimin periodik të datës 27.03.2006.

Sa më sipër, është plotësisht e vërtetueshme, nëpërmjet organeve zyrtare financiare kanadeze, që unë asnjëherë nuk kam pasur apartament të blerë në Kanada, si edhe shumën prej 400.000 dollarësh kanadezë në ndonjë llogari bankare në atë vend apo të jetë lëvizur një shumë e tillë nga Shqipëria në Kanada dhe anasjelltas.

Çdo gjë si më lart, e deklaruar nga unë në deklaratën e vitit 2004 dhe 2006, ka ardhur si rezultat i mospasjes së një faqeje ku të deklarohej për prona apo likuiditete, të cilat ishin në pritshmëri ardhjeje për subjektin deklarues. Në këto kushte unë, deklaruesi, u këshillova nga zyrtarët e ILDKPKI-së t'i pasqyroj në deklaratimet e mia, por duke i vënë fjalën "pa hipotekuar". Në Kanada, blerja e një prone shoqërohet në mënyrë të menjëhershme me dokumentin hipotekor të pronësisë, gjë që unë nuk e kam pasur ndonjëherë.

Në vitin 2010 apo 2011 (nuk e mbaj mend ekzakt vitin), mua më ra shorti në ILDKPKI për kontroll të thellë. Nga ky organ, jam thirrur nga inspektori dhe kam dhënë shpjegime për gjithçka në lidhje me deklaratën e vitit 2004 dhe atë të vitit 2006, vit në të cilin unë mora postin e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Shpjegimet e mia janë të njëjta me të asaj kohe, kur unë jam pyetur nga ILDKPKI-ja. ILDKPKI, mbasi kreu të gjitha veprimet e saj, mendoj se arriti në një konkluzion. Ky konkluzion i saj duhet të ketë qenë në favorin tim, pasi unë kam vazhduar në detyrë që nga ajo kohë dhe deri më sot. Në këto kushte, mendoj se ky objekt kontrolli është i ezauruar. Sa më lart, deklarohet në vullnetin dhe përgjegjësinë time ligjore.

- 9.** Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në raportin e paraqitur pranë Komisionit për subjektin Fatos Lulo, ka dalë në konkluzionin se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, është kryer deklarim i rremë dhe nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesave. Në shkresën "Kthim përgjigje", me nr. 4021/1, datë 30.11.2017, ILDKPKI i është përgjigjur Komisionit: *Në deklaratimet ndër vite të subjektit Fatos Lulo, pasuria e deklaruar është 78.000.000 lekë. Të ardhurat e ligjshme të deklaruara nga subjekti ndër vite janë në shumën 30.100.635 lekë. Si konkluzion, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar ndër vite më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme.*
- 10.** Subjekti i rivlerësimit Fatos Lulo ka filluar të deklarojë pasurinë që në momentin e fillimit të detyrës në vitin 2004 dhe ka vazhduar me deklarimin vjetor periodik për vitin 2004 si më poshtë:
 - a- Apartament banimi, me sipërfaqe 109 m², rruga e "{***}", vlera 9.300.000 lekë, pjesa që zotëron 100%, pallati {***}, Tiranë.
Burimi (blerë nga kursimet familjare, plus shitjen e banesës së privatizuar)

- b- Apartament banimi, me sipërfaqe 150 m², vlera 14.200.000 lekë, pjesa që zotëron 100%, Toronto, Kanada.
Burimi (blerë nga aktiviteti im si avokat)
 - c- Ambient zyre, me sipërfaqe 74 m², rruga “{***}”, Tiranë, pjesa që zotëron 100%, vlera 13.800.000 lekë.
Burimi (blerë nga aktiviteti im si avokat)
 - ç- Autoveturë tip “Peugeot”, vlera 1.500.000 lekë, pjesa që zotëron 100%.
Burimi (blerë nga kursimet e mia)
 - d- Pikturë copë 1 (një), vlera 5.000.000 lekë, në banesën e tij Tiranë.
Burimi (blerë nga kursimet e mia)
 - dh- Depozitë jashtë vendit në Toronto, Kanada, 400.000 CAD = 33.104.000 lekë.
Burimi (nga puna në emigracion)
 - e- Hua marrë motrës sime D.L, shuma 480.000 USD.
(Blerje e një shtëpie banimi në Kanada, si dhe nisja e një biznesi privat)
- 11.** Për periudhën vjetore 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si më poshtë:
- a- *Shitje apartamenti në Toronto, Kanada 160.000 CAD = 14.200.000 lekë.*
 - b- *Shitje e autoveturës tip “Peugeot” 12.000 euro = 1.500.000 lekë.*
 - c- *Gjendja e depozitës në Kanada = 0. Tërhequr gjithë shuma për shlyerjen e huas.*
 - ç- *Huaja e marrë motrës sime D.L është shlyer plotësisht me shitjen, mos hapjen e biznesit të planifikuar, si dhe nga puna ime në shumën prej 480.000 USD (47.304.000 lekë).*
- 12.** Në vitin 2007-2008 subjekti ka deklaruar:
- Para *cash* të dhuruara në shumën 100.000 USD = 8.300.000 lekë. Pjesa që zotëron 100%, (dhuratë nga motra ime D.L, e cila është në biznes ndërtimi si bashkëpronare me firmën “{***}” SHPK. Kjo shumë është dhuruar në bazë të kontratës 1369 rep., nr. 547, kol., datë 21.02.2008).
- 13.** Në vitin 2009 subjekti ka deklaruar:
- Dhuruar nga motra ime një ambient zyre, me sipërfaqe 172 m², Rruga {***}, Tiranë, me vlerë 120.000 euro = 14.856.000 lekë.
*Burimi (sqaroj se motra ime D.L është ortake e firmës së ndërtimit “{***}” SHPK)*
- 14.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 12, datë 23.03.2018, ka vendosur: Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Fatos Lulo, gjyqtar pranë Gjykatës Kushtetuese, me arsyetimin se për të ardhurat dhe asetet, totali i pasurisë së deklaruar është 78.707.222 lekë, ndërsa të ardhurat e ligjshme janë 30.100.635 lekë, duke përbërë kështu dyfishin e pasurisë së ligjshme, përfshirë dhe personat e lidhur, si dhe për deklarim të rremë dhe mungesë të burimeve të ligjshme për pasurinë e deklaruar.
- 15.** Vlera e përlllogaritur nga Komisioni, për sa u përket pasurive të deklaruara nga subjekti, është 78.707.222 lekë, si rezultat i përlllogaritjes së aseteve si më poshtë:
- a. apartament banimi, 112 m², në Tiranë, 9.300.000 lekë;
 - b. apartament banimi, në Kanada, 150 m² 160.000 CAD = 14.200.222 lekë;
 - c. ambient zyre, 74 m² (dhënë me huapërdorje nga motra D.L, me të drejtë shitjeje) 13.800.000 lekë);
 - ç. para *cash* të dhuruara nga motra D.L, 100.000 USD = 8.303.000 lekë;
 - d. depozitë në Kanada, 400.000 CAD = 33.104.000 lekë.

Totali i pasurisë së deklaruar: 78.707.222 lekë.

Të ardhurat e ligjshme që ka deklaruar subjekti i rivlerësimit sipas vendimit të Komisionit janë:

- a. Të ardhura nga paga si jurist në organe të ndryshme shtetërore 90.000 lekë.
- b. Të ardhura nga aktiviteti si avokat për vitet 1995-1999 dhe vitet 2002-2005, shuma 4.170.100 lekë.
- c. Të ardhura nga paga si gjyqtar i Gjykatës së Lartë (2006-2013), shuma 11.938.448 lekë.
- ç. Të ardhura nga paga si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese (2013-janar 2017), shuma 6.997.637 lekë.
- d. Të ardhura të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, punësim pranë Akademisë së Shkencave për vitet 1994-1998 dhe 2002-2008, shuma 5.997.600 lekë.
- dh. Të ardhura të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit si mësuese në shkollën “{***}” për vitet 2014-2015, shuma 270.000 lekë.
- e. Të ardhura të bashkëshortes nga shitja e apartamentit, rruga “{***}”, 5.000 USD.

Totali i të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur është: 30.100.635 lekë.

III.

III/1. Analiza e shkaqeve të ankimit për shkelje procedurale të pretenduara

16. *Lidhur me pretendimin në ankim, se vendimi i Komisionit është në kundërshtim me ligjin nr. 76/2016 dhe ligjin nr. 84/2016, për arsye se Komisioni e përfundoi procesin e rivlerësimit për vetëm një kriter, trupi gjykues vlerëson se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Vendimi i Komisionit është në përputhje me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili shpreh qartë: Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave. Në bazë të këtij parashikimi ligjor, Komisioni ka filluar hetimin administrativ për të tria kriteret e vlerësimit. Gjatë këtij hetimi, Komisioni pasi ka vlerësuar se e ka hetuar në mënyrë të plotë kriterin e pasurisë, bazuar në provat e grumbulluara dhe vlerën e tyre provuese, ka arritur në përfundimin se vlerësimi i subjektit të rivlerësimit mund të bëhej edhe vetëm për këtë kriter, pa qenë nevoja e përfundimit të hetimit të plotë edhe të dy kriterëve të tjera.*

17. *Lidhur me pretendimin në ankim se nuk janë zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe parimet e tij, arsyetojmë se:*

Ligji nr. 84/2016 parashikon në nenin 4, pika 6 se: Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

Parimet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile mund të zbatohen në këtë proces vetëm për çështje të parregulluara në mënyrë specifike nga legjislacioni si më sipër cituar. Pretendimi i ankuesit lidhur me moszbatimin e këtyre parimeve, konsiderohet i

pabazuar nga trupi gjykues, pasi nga tërësia e dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se në të gjithë procesin e rivlerësimit të realizuar nga Komisioni janë respektuar të gjitha parimet e procesit të rregullt ligjor, pasi subjektit të rivlerësimit i është garantuar e drejta e njohjes me të gjitha aktet e hetimit administrativ dhe e kundërshtimit të tyre, e drejta e paraqitjes së provave, e drejta e dëgjimit në seancë publike, e drejta e mbrojtjes me avokat, si dhe e drejta e ankimit të vendimit të rivlerësimit në një gjykatë të pavarur e të paanshme.

Rezultoni se subjektit të rivlerësimit, më datë 14.02.2018, ora 02.22, i është dërguar *e-mail* nga Komisioni për të ushtruar të drejtat që ai ka lidhur me procesin, bazuar në nenet 46 dhe 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në formë zyrtare me shkresë nr. 2417 prot., datë 09.03.2017, kjo e fundit në përgjigje të kërkesës së avokatit mbrojtës të subjektit të rivlerësimit, më datë 02.03.2018.

Në kuptim të parimit të barazisë së armëve, Komisioni i ka dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtjes që e ka përfaqësuar atë në këtë proces, për të paraqitur edhe prova të reja, të ndryshme nga ato të paraqitura gjatë afatit të dhënë nga Komisioni përpara seancës dëgjimore.

Në kuptim të parimit të dhënies së një vendimi të bazuar në ligj e në prova, vendimi i dhënë nga Komisioni në të gjithë arsyetimin e tij rendit të gjitha provat, si dhe ligjin e zbatueshëm në secilën analizë, të çdo pasurie apo të ardhure të subjektit të rivlerësimit. Në kuptim të parimit për një proces të rregullt ligjor, subjektit të rivlerësimit i është dhënë nga Komisioni informacion i plotë lidhur me procesin; i është dhënë koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes; e drejta që të mbrohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij; e drejta për të marrë provat që ai gjykon në favor të mbrojtjes. Gjithashtu, subjekti përmes përfaqësuesit të zgjedhur prej tij është dëgjuar nga një komision i pavarur dhe i paanshëm në seancat dëgjimore publike.

18. *Lidhur me pretendimin në ankim se vendimi i Komisionit është konfuz, i paqartë, me përsëritje të vazhdueshme, me mungesë analize juridike të fakteve, trajtim të njëanshëm të provave dhe shprehje kontradiktore të paqarta, se vendimi nuk është i arsyetuar dhe nuk përmban elementet thelbësore të vendimit, arsyetojmë se vendimi i Komisionit është në përputhje të plotë me nenin 57 të ligjit nr. 84/2016. Ai përmban të gjithë elementet thelbësore të një vendimi, duke pasur këtu në konsideratë edhe vendimin nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin nr. 63, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese. Duke e vlerësuar arsyetimin e vendimit nr. 12, datë 23.03.2018, të dhënë nga Komisioni, në këndvështrim të plotësimin të elementeve të përcaktuara nga jurisprudenca, konstatojmë se vendimi përkatës përmban bazën ligjore mbi të cilën bazohet procesi i rivlerësimit, analizën e provave të administruara, si dhe vlerësimin e Komisionit në lidhje me hetimin administrativ ndaj ankuesit dhe caktimin e masës disiplinore. Në të është bërë një analizë e plotë e provave që janë përdorur për secilën pasuri apo të ardhur të hetuar, si dhe baza ligjore e zbatueshme në secilin prej rasteve. Ky vendim nuk është alogjik dhe nuk përmban ndonjë kundërthënie të hapur ose të fshehtë.*

19. *Lidhur me pretendimin në ankim se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në hetimin e vet administrativ, si dhe në vendimin e tij ka tejkalar tagrat dhe kompetencat e tij që i janë ngarkuar nga ligji, gjë e cila ka sjellë si pasojë cenimin e parimit të ligjshmërisë. Subjekti duhet të ishte hetuar që nga fillimi i ushtrimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë e deri më sot, pra nga data 13.02.2006 (kur është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë) dhe jo përpara kësaj date.*

Trupi gjykues vlerëson se Komisioni nuk ka tejkalar tagrat që i parashikon ligji, pasi subjekti Fatos Lulo ka qenë subjekt deklarues nga viti 2004 deri në vitin 2017. Kjo

provohet me provat shkresore në dosje, dokumente që provojnë të qenit e tij subjekt deklarues. Për këtë arsye, pretendimi i ankuesit nuk qëndron. Neni Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës parashikon ndër të tjera se Komisioni dhe Kolegji kanë të drejtë të shqyrtojnë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij. Bazuar në këtë parashikim të Kushtetutës, neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 i njohin Komisionit dhe Kolegjit të drejtën të marrin në cilësinë e provës edhe deklaratat e mëparshme të pasurisë së subjektit. Ky nen parashikon: *Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit*. Kjo do të thotë që, nëse subjekti e ka deklaruar një pasuri të caktuar në deklaratimet e tij të mëparshme, Komisioni dhe Kolegji kanë të drejtë të kërkojnë burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe ligjshmërinë e tij. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklaratës së pasurisë (*vetting*) sipas ligjit nr. 84/2016, e kanë të domosdoshëm analizimin e deklaratimeve të mëparshme të pasurisë, të bëra nga subjektet e deklarimit të pasurisë, dhe krahasimin e tyre me deklaratën e pasurisë (*vetting*).

20. *Lidhur me pretendimin në ankim se subjekti i rivlerësimit duhej të hetohej vetëm për 7 vitet e fundit, pra 2011-2017, e jo për gjithë kohën, për shkak se ka kaluar në hetim të thelluar administrativ nga ILDKPKI-ja në vitin 2011, shprehemi se subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen ligjit nr. 84/2016, si ligj i posaçëm për hetimin e pasurive, figurës dhe anës profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe se hetimi i mëparshëm i ILDKP-së, që është i bazuar në ligjin nr. 9049/2003, nuk mund të përbëjë gjë të gjykuar në kuadër të ligjit nr. 84/2016. Ashtu siç shpjeguam më sipër, në bazë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit.*
21. *Lidhur me pretendimin në ankim se ILDKPKI-ja me konkluzionet e saj ka dalë jashtë tagrave që i parashikon ligji, kur është shprehur që subjekti ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, gjë e cila është jashtë kriterëve që parashikon neni 33 i ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se ILDKPKI nuk ka kaluar tagrat që i ka parashikuar ligji, pasi është shprehur brenda kriterëve që parashikon neni 33 i ligjit nr. 84/2016. Pikërisht në raportin përfundimtar të ILDKPKI-së, të administruar në dosje dhe paraqitur në Komision me nr. 633/34 prot., datë 06.01.2017, ILDKPKI-ja ka raportuar se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme, është kryer deklarim i remë, si dhe nuk gjendet në konflikt interesi. Për sa i përket pretendimit të subjektit, që ILDKPKI-ja ka tejkalar tagrat duke përlllogaritur dyfishin e pasurisë në kundërshtim me kompetencat që i jep ligji, rezulton se është bërë një kërkesë nga trupa e Komisionit drejtuar Inspektorit të Përgjithshëm me nr. 516-5/8, datë 22.11.2017, për analizë financiare. ILDKPKI-ja është shprehur në këtë përgjigje se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar ndër vite më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme, çfarë do të thotë se ILDKPKI-ja në asnjë rast nuk ka tejkalar tagrat që i parashikon ligji, neni 33/5 i ligjit nr. 84/2016, por ka bërë një analizë financiare të kërkuar nga Komisioni.*
22. *Lidhur me pretendimin në ankim se nuk janë trajtuar provat në mënyrë të barabartë, nuk janë marrë parasysh vendimet e gjykatës depozituar nga subjekti i rivlerësimit, por janë trajtuar në mënyrë të njëanshme shkresat e DRT Tiranë nr. 77111/1, datë 23.01.2017, shkresa DRT Tiranë nr. 4831/1 prot., datë 27.01.2017 dhe shkresa e DRT Tiranë nr. 66148/1 prot., datë 19.12.2017, vlerësojmë se Komisioni në vendimin e tij ka marrë në shqyrtim vendimet e gjykatës për regjistrimin e subjektit si person fizik për ushtrimin e profesionit të avokatit, por nuk i ka konsideruar ato me vlerë provuese për justifikimin e pasurisë së subjektit. Është fakt që në dosjen gjyqësore gjendet në cilësinë e provës librezë e punës së subjektit të rivlerësimit, në të cilën pasqyrohet se, për*

periudhën 1994-2003 subjekti i rivlerësimit ka marrëveshje me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për sigurim vullnetar, që do të thotë se subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar sigurime të detyrueshme shoqërore në cilësinë e personit fizik (avokat), por i ka paguar ato vullnetarisht, çka vërteton faktin se ai nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore si avokat. Në analizë të fundit, është i drejtë qëndrimi i Komisionit sa i takon vlerësimit të faktit që subjekti nuk disponon Certifikatë Tatimore apo Kod Fiskal, por kjo në kuptim të sa më lart arsyetuar dhe jo në interpretim të shkresave të organeve tatimore.

23. Lidhur me pretendimin në ankim se subjekti nuk është vënë në dijeni për pamjaftueshmëri të provave, veçse në momentin e komunikimit të raportit përfundimtar, siç kemi arsyetuar edhe më sipër, subjektit të rivlerësimit i është dhënë mundësia për t'u mbrojtur dhe për të paraqitur të gjitha provat që ai i gjykon të nevojshme, me e-mail të datës 14.02.2018 dhe shkresën nr. 2417, datë 09.03.2017 të Komisionit drejtuar subjektit. Në përgjigje të e-mail-it si më sipër, nga subjekti i rivlerësimit është kthyer përgjigje me e-mail të datës 28.02.2018, përmes të cilit subjekti ka paraqitur të gjitha pretendimet e tij edhe në këtë fazë të hetimit, përveç seancës dëgjimore. Për sa më sipër, nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.
24. Lidhur me pretendimin në ankim se nuk është përcaktuar një metodologji për përcaktimin e të ardhurave, shprehemi se nuk është i nevojshëm aplikimi i një metodologjie të caktuar, pasi, bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, të cilat konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Duke qenë se subjekti është në kushtet e paaftësisë për të vërtetuar të ardhura të ligjshme, për periudhën 1994-2003, kjo edhe në kuptim të qëndrimit si më sipër, nuk mund të aplikohet një metodologji e caktuar.

III/2 Analiza e shkaqeve të ankimit të lidhura me pasurinë dhe të ardhurat:

25. Për apartamentin e banimit në rr. “{***}” + depo + sipërfaqe e azhurnuar, 112 m² + 15 m² + 2.5 m², fituar me kontratë sipërmarrjeje datë 08.12.2001 dhe kontratë shitjeje datë 24.03.2014, me burim të deklaruar të të ardhurave nga ushtrimi i aktivitetit si avokat dhe paga e bashkëshortes. Vlera 50000 USD, plus shpenzime mobilimi, barabartë me 9.300.000 lekë.

Për këtë pasuri, trupi gjykues shqyrtoi këto prova:

- i. Shkresat e ZVRPP Tiranë nr. 42095/1 prot., datë 05.12.2017 dhe nr. 42646 prot., datë 06.12.2017, si edhe 23 shkresa nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku konfirmohet se në emër të subjektit ekzistonte prona e sipërpërmendur, e regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë në vitin 2014.
- ii. Shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nr. 66148/1 prot., datë 19.12.2017.
- iii. Shkresën e Akademisë së Shkencave nr. 63/1 prot., datë 27.01.2017.
- iv. Vërtetimin nga Qendra e Studimeve Gjeografike, nr. ekstra prot., datë 11.11.2008.

Trupi gjykues konstaton se ky deklaram i bërë në deklaratën e pasurisë (vetting) 2017 dhe në deklaratën e pasurisë të vitit 2004 është me të njëjtën vlerë, 9 300 000 lekë. Lidhur me burimin financiar për blerjen e këtij apartamenti, subjekti Fatos Lulo

deklaron në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 si burim “Me të ardhurat e ushtrimit të aktivitetit si avokat dhe paga e bashkëshortes” ndërsa në deklarinimin e vitit 2004, kishte bërë një deklarinim të ndryshëm “Blerë me kursimet familjare plus shitje e banesës së privatizuar”. Gjithashtu, nga përlllogaritja e të ardhurave të ligjshme të subjektit nuk justifikohet blerja e këtij apartamenti. Nga analiza e provave që subjekti i ka bashkëlidhur deklarinimit rezulton se pagesa e apartamentit të mësipërm është likuiduar në vitin 2001, kjo vërtetuar me mandat arkëtimin e datës 04.12.2001 në shumën 50.000 USD. Sipas dokumentacionit që është administruar në dosje, nuk rezulton që subjekti në vitin 2004 të kishte burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë. Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, R.L, nga viti 1994-2001 janë në vlerën 2.731.265 lekë. Kjo referuar provave, si vijojnë: a) shkresë e Akademisë së Shkencave nr. 63/1 prot, datë 27.01.2017; dhe b) vërtetim page R.L nga Qendra e Studimeve Gjeografike, me nr. Ekstra prot., më datë 11.11.2008.

Të ardhurat e subjektit për periudhën 1994-2003 janë në vlerën (0) zero lekë. Është fakt që në dosjen gjyqësore gjendet në cilësinë e provës librezë e punës, në të cilën pasqyrohet se, për periudhën 1994-2003 subjekti i rivlerësimit ka marrëveshje me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për sigurim vullnetar, që do të thotë se subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar sigurim të detyrueshëm shoqëror në cilësinë e personit fizik – avokat, por i ka paguar ato vullnetarisht, pra ai nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore si avokat. Gjithashtu, këtu nuk janë të përlllogaritura shpenzimet e jetesës së subjektit dhe personave të lidhur me të.

Për sa më sipër, është i drejtë vendimi i Komisionit kur konkludon se, referuar pikës 3 të nenit 61, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

- 26.** Për dhuratat dhe huat e dhëna nga motra e subjektit të rivlerësimit, znj. D.L:
- i. Për njësinë nr. 20 (e konsideruar nga subjekti si zyrë), me sip. 172 m², me vlerë 120.000 euro, e ndodhur në Rruga {***}, vlera 120.000 euro, e barasvlershme në shumën 14.856.000 lekë, fituar me kontratë dhurimi, datë 06.12.2011.
 - ii. Dhurimi i një shume prej 100.000 USD me kontratën nr. 1369 rep., dhe nr. 547 kol., datë 21.08.2008, nga znj. D. L, e konsumuar në vitet 2008- 2016.
 - iii. Huan në *cash*, në shumën prej 480.000 USD, me anë të kontratës së huas nr. 5120, datë 04.09.2000.
 - iv. Kontratën e huapërdorjes, datë 22.10.2002, për zyrën (e ish-avokatisë) në rr. “{***}”, me sipërfaqe 74 m², në përdorim me të drejtë blerjeje në shumën 13.800.000 lekë.

Trupi gjykues për këto pasuri shqyrtoi provat si vijojnë:

- i. Deklaratat periodike të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, përfshirë deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017.
- ii. Shkresën e ZVRPP Tiranë nr. 42095/1, datë 05.12.2017, dhe nr. 42646, datë 06.12.2017.
- iii. Kontratën premtim dhurimi nr. 1661 rep., nr. 622 kol., datë 15.03.2009, ku konfirmohet se vlera e këtij apartamenti është 120.000 euro.
- iv. Shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nr. 66148/1 PROT., datë 19.12.2017.
- v. Shkresën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore nr. 729-5/2 prot., datë 13.12.2017, për sigurimet shoqërore që ka paguar znj. D.L.
- vi. Shkresën me nr. 174/2, datë 17.01.2018, nga notere M.Sh., dhe nr. 174 datë

- 08.01.2018, ku dërgohen kopje të kontratave të dhurimit dhe dokumenteve bashkëngjitur, me anë të së cilës vërtetohet se çmimi i blerjes së zyrës 174 m² është 120.000 euro.
- vii. Kontratë premtim dhurimi nr. 1661, rep., nr. 622 kol., datë 15.03.2009.
 - viii. Dy kontratat e sipërmarrjes për ndërmjetësim lejesh ndërtimi lidhur midis shoqërisë “{***}” SHPK dhe znj. D.L nr. 7740 rep., nr. 2916 kol., datë 04.12.2000 dhe nr. 1418 rep., nr. 523 kol., datë 27.02.2006.
 - ix. Kontratë huapërdorjeje, e datës 22.10.2002, për zyrën (e ish-avokatisë) në rrugën “{***}”, me sipërfaqe 74 m², në përdorim me të drejtë blerjeje, në shumën 13.800.000 lekë.
 - x. Përgjigjen e subjektit me anë të postës elektronike, më datë 07.02.2018, në bazë të kërkesës së Komisionit që të deklarojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive:
 - (i) njësisë nr. 20, me sipërfaqe 172 m², e ndodhur në Rruga {***}, e dhuruar nga motra e subjektit në vlerën prej 120.000 eurosh; dhe (ii) shumës prej 100.000 USD, të dhuruar përsëri nga motra e subjektit.

Në lidhje me dokumentacionin justifikues ligjor të burimit të deklaruar të të ardhurave që ka shërbyer për:

- (i) blerjen e asetit zyrë, me sipërfaqe 172 m², me vlerë 120.000 euro nga znj. D.L, njësi e cila më pas i dhurohet subjektit Fatos Lulo;
- (ii) dhurimin e shumës prej 100.000 (njëqind mijë) dollarësh amerikanë për shkollimin e fëmijëve;
- (iii) zyrën prej 74 m² dhënë me kontratë huapërdorje subjektit të rivlerësimit me të drejtë parablerjeje në shumën prej 13.800.000 lekësh; si dhe
- (iv) shumën prej 480.000 (katërqind e tetëdhjetë mijë) USD dhënë hua subjektit të rivlerësimit nga motra e tij, znj. D.L;

duke analizuar deklarin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë (*vetting*), shpjegimet dhe provat/dokumentet e paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe avokatit të tij, deklarin e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike, si dhe provat shkresore të administruara si më sipër, trupi gjykues konkludon se znj. D.L, në cilësinë e dhurueses së njësisë/zyrës nr. 20, me vlerë prej 120.000 eurosh dhe shumës *cash* prej 100.000 USD, të cilat janë deklaruar me anë të kontratave të dhurimit, nuk ka pasur të ardhura financiare të ligjshme në kuptim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, që kanë shërbyer si burim për blerjen e njësisë nr. 20 në shumën 120.000 euro, e që më pas i është dhuruar z. Fatos Lulo. Gjithashtu, znj. D.L nuk ka pasur të ardhura prej 100.000 USD që më pas t’ia dhuronte subjektit të rivlerësimit.

Znj. D.L, në cilësinë e huadhënëses së subjektit të rivlerësimit për shumën prej 480.000 USD, të cilët janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklarin vjetor të vitit 2004 dhe të një zyre prej 74 m² me vlerë 13.800.000 lekë sipas kontratës së huapërdorjes të vitit 2002, nuk ka pasur të ardhura financiare të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.*

- 27.** *Lidhur me pretendimin në ankim të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka gabuar kur ka interpretuar se znj. D.L duhet të ishte aksionere ose të kishte ndërtuar një ortakëri të thjeshtë me shoqërinë “{***}” SHPK., kjo në zbatim edhe të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, gjykojmë që ky është një pretendim i drejtë i ankuesit, pasi kontratat e sipërmarrjes mes palëve përbëjnë një marrëdhënie*

juridike civile, mbi bazën e të cilave znj. D.L shfaqet në cilësinë e personit që do të ofrojë një shërbim të caktuar dhe shoqëria “{***}” SHPK do të paguajë një çmim në formën e përcaktuar në kontratë. Pra, kemi të bëjmë me një shprehje të lirë të vullnetit të palëve. Lidhur me zbatimin e gabuar në kohë të ligjit nr. 9901/2008, gjithashtu është i drejtë pretendimi i subjektit se Komisioni ka gabuar kur ka zbatuar dispozitat e këtij ligji për të interpretuar kontratën e sipërmarrjes nr. 7740 rep., nr. 2916 kol., datë 04.12.2000 dhe kontratën nr. 1418 rep., nr. 523 kol., datë 27.02.2006, porse kjo nuk përbën një të metë serioze që të cenojë urdhërimet e vendimit të Komisionit.

28. Për sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë vendimin e Komisionit se, nga ana e subjektit të rivlerësimit ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e këtyre të ardhurave nga znj. D.L dhe deklarim të rremë, për pasojë, referuar nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji.

29. Për pasuritë:

- i. Apartament banimi në ndërtim, 150 m², Toronto, Kanada, vlera 14.200.000 lekë, i pahipotekuar. *Burimi - blerë nga aktiviteti si avokat.*
- ii. Depozitë jashtë vendit në Toronto, Kanada, në shumën 400.000 CAD.
Burimi - nga puna në emigracion.

Për këto pasuri trupi gjykues shqyrtoi provat si vijojnë:

- i. Deklaratën personale shtesë të datës 30.01.2017, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017.
- ii. Deklaratën e pasurisë “Para Fillimit të Detyrës, 2004”. Formulari A-1, ku deklarohet apartament banimi në ndërtim, 150 m², vlera 14.200.000 lekë, i pahipotekuar, në Toronto, Kanada; dhe depozitë jashtë vendit 400.000 CAD në Toronto, Kanada, dhe marrjen hua të shumës prej 480.000 USD motrës D.L.
- iii. Deklaratën e pasurisë, periodik, për vitin 2005.
- iv. Deklaratën e pasurisë, periodik, për vitin 2006.

Trupi gjykues e gjen të drejtë vendimin e Komisionit, kur arsyetohet se referuar nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të rremë në lidhje me:

- i. Asetin apartament banimi në ndërtim, 150 m², Toronto, Kanada, vlera 14.200.000 lekë, i pahipotekuar, blerë nga aktiviteti si avokat, pasi subjekti ka deklaruar se këtë aset nuk e ka pasur ndonjëherë.
- ii. Depozitën jashtë vendit në Toronto, Kanada, në shumën 400.000 CAD, me burim nga puna në emigracion, pasi subjekti ka deklaruar se këtë likuiditet nuk e ka pasur ndonjëherë.
- iii. Qëllimin dhe përdorimin e kësaj shume.
- iv. Shitjen e apartamentit në Toronto, Kanada, në shumën 160.000 CAD, pasi subjekti ka deklaruar se këtë aset nuk e ka pasur ndonjëherë.
- v. Mbylljen e depozitës në Toronto, Kanada, në shumën 400.000 CAD, me qëllim shlyerjen e huas, pasi subjekti ka deklaruar se këtë aset nuk e ka pasur ndonjëherë.
- vi. Shlyerjen e huas motrës, znj. D.L, në shumën 480.000 USD, deklaruar me shitjen dhe moshapjen e biznesit të planifikuar, nga puna dhe mbyllja e depozitës në Toronto, Kanada, ndërkohë që subjekti ka deklaruar se biznesi nuk u hap ndonjëherë dhe

depozita në Toronto, Kanada, nuk ka ekzistuar ndonjëherë.

- 30.** Trupi gjykues pas analizës së të gjitha pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Fatos Lulo, arrin në përfundimin se totali i pasurisë së subjektit të rivlerësimit sipas deklaramit të pasurisë *vetting* dhe të deklarimeve paraardhëse për periudhën 2004-2017 është në vlerën e konstatuar nga Komisioni 78.707.222 lekë.
- 31.** Të gjitha konkluzionet e parashtruara më sipër u arritën nga trupi gjykues në bazë të analizës dhe vlerësimit në tërësinë e tyre të vlerave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe provave shkresore të shqyrtuara si më poshtë:
- a. *Deklarata e pasurisë (vetting) e vitit 2017 dhe deklaratat paraardhëse.*
 - b. *Kontratë - sipërmarrje nr. 2326 rep., datë 08.12.2001 për apartament me sipërfaqe 112 m², me vlerë 50.000 USD, rruga “{***}”, Tiranë. Vlera në total është 9.300.000 lekë.*
 - c. *Kontratë shitje - pasurie të paluajtshme nr. 1514 rep., nr. 748 kol., datë 24.03.2014, me vlerë totale 50.000 USD. Rruga “{***}”, Tiranë.*
 - ç. *Mandat arkëtimi, datë 04.12.2001, ku Fatos Lulo arkëton shumën 50.000 USD dhe mandat arkëtimi, datë 08.12.2001, për shumën e arkëtuar 5.000 lekë.*
 - d. *Certifikatë për vërtetim pronësie nr. 843450, datë 02.04.2014 dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme për depo me sip. 15 m².*
 - dh. *Certifikatë për vërtetim pronësie nr. 843451, datë 02.04.2014, dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme për depo me sip. 2,5 m².*
 - e. *Certifikatë për vërtetim pronësie nr. 843009, datë 02.04.2014, dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme për depo me sip. 112 m².*
 - ë. *Kontratë Dhurimi nr. 1369 rep., nr. 547 kol., datë 21.02.2008 për vlerën 100.000 USD.*
 - f. *Kontratë dhurimi pasurie të paluajtshme nr. 9327 rep., nr. 3942 kol., datë 06.12.2011 për njësinë me nr. 20, me sipërfaqe 172 m², e ndodhur në Rruga {***}.*
 - g. *Kontratë premtim - dhurimi nr. 1661 rep., nr. 622 kol., datë 15.03.2009.*
 - gj. *Vërtetim nga Dokumenti Hipotekor, datë 26.12.2011.*
 - h. *Kontratë sipërmarrje nr. 7740 rep., nr. 2916 kol., datë 04.12.2000, duke ndërmjetësuar për nxjerrje lejesh ndërtimi.*
 - i. *Kontratë sipërmarrje nr. 1418 rep., nr. 523 kol., datë 27.02.2006, duke ndërmjetësuar për nxjerrje lejesh ndërtimi dhe ndihmë ndërmjet “{***}” SHPK dhe znj. D.L.*
 - j. *Shkresë e Bashkisë Tiranë nr. 148658 prot., datë 03.08.2017.*
 - k. *Shkresë e Bashkisë Tiranë nr. 134871/1 prot., datë 04.07.2017, përmes së cilës konfirmohet se subjekti nuk ka shlyer detyrimet vendore për pasurinë 172 m² në adresën Rruga {***}.*
 - l. *Shkresë e Credins Bank nr. 31794/1 prot., datë 23.06.2017.*
 - ll. *Shkresë e Raiffeisen Bank nr. 23175/1 prot., datë 27.06.2017.*
 - m. *Shkresë e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Tiranë, me nr. 42095/1, datë 05.12.2017, dhe shkresë me nr. 42646, datë 06.12.2017, në të cilat konfirmohet se cilat pasuri të paluajtshme janë në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të etj.*
- 32.** Trupi gjykues pas analizës së të gjitha të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, arrin në përfundimin se është e drejtë përlllogaritja e Komisionit që këto të ardhura janë në shumën 30.100.635 lekë. Të gjitha të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur u përlllogaritën në bazë shqyrtimit të provave si më poshtë:

- a. *Shkresë e Akademisë së Shkencave nr. 63/1 prot., datë 27.01.2017*
- b. *Vërtetim page, R.L, nga Qendra e Studimeve Gjeografike, me nr. Ekstra prot., datë 11.11.2008.*
- c. *Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. 5179 rep., nr. 1633 kol., datë 02.10.1996.*
- ç. *Vërtetim të ardhurash për znj. R.L nga shkolla “{***}”, datë 27.01.2017.*
- d. *Librezë pune R.L me nr. regjistri 21.*
- dh. *Kërkesë e subjektit drejtuar Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, datë 27.12.2016.*
- e. *Kërkesë e subjektit drejtuar DRT Tiranë, datë 26.01.2017.*
- ë. *Shkresë nr. 66148/1 prot., datë 19.12.2017, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.*
- f. *Shkresë nr. 77111/1 prot., datë 23.01.2017, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.*
- g. *Shkresë nr. 4831/1 prot., datë 27.01.2017, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.*
- gj. *Vërtetim të ardhurash si jurist nga organe të ndryshme shtetërore.*
- h. *Vërtetim të ardhurash nr. 3841/1 prot., datë 18.10.2016, për z. Fatos Lulo nga Gjykata e Lartë për periudhën 17.02.2006 – 02.05.2013.*
- i. *Vërtetim të ardhurash nr. 32 prot., datë 09.01.2017 për zotin Fatos Lulo nga Gjykata Kushtetuese për periudhën 02.05.2013 – 31.12.2016.*
- j. *Librezë pune e Fatos Lulo me nr. regjistri 1481.*
- k. *Vendim nr. 3743 Akti, datë 05.10.1995 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin si person fizik.*
- l. *Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 04.11.1997.*
- ll. *Vendim nr. 26564, datë 10.02.2004 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin si person fizik etj.*

33. Në këto kushte, trupi gjykues pasi analizoi faktet që kanë rëndësi për çështjen si dhe vlerësoi të gjitha provat si më sipër, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, përfshirë dhe personat e lidhur me të (vlera e pasurisë së deklaruar 78.707.222 lekë në raport me të ardhurat e ligjshme në vlerën 30.100.635 lekë).

Në analizë të sa më sipër, bazuar në nenin “D”, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, e cila parashikon: *Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën*, si dhe në nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: Kur Kolegji i Posaçëm i Apelit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të, trupi gjykues për sa i përket masës disiplinore të dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 12, datë 23.03.2018, çmon se ky vendim duhet lënë në fuqi.*

34. Referuar Kushtetutës, Aneksit të saj, nenit “D”, pika 3, *Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elementet e tjera të pasurisë së ligjshme*

përcaktohen me ligj. Subjekti Fatos Lulo nuk ka justifikuar sipas parashikimit të kësaj dispozite kushtetuese burimin e ligjshëm të të ardhurave për pasuritë e deklaruara në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 dhe deklaratat paraardhëse të pasurisë, ka bërë deklaratime të rreme dhe, për pasojë, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 ka bërë deklaratim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji. Trupi gjykues për sa i përket masës disiplinore të dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 12, datë 23.03.2018, çmon se ky vendim duhet lënë në fuqi.

- 35.** Kolegji i Posaçëm i Apelimit si i vetmi organ gjyqësor, i pavarur dhe i paanshëm, i procesit të rivlerësimit, pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, mbi bazën e parimeve të barazisë para ligjit, kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, proporcionalitetit, parime këto që garantojnë të drejtën e subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, bazuar në arsyet e parashtruara më lart, vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 12, datë 23.03.2018 është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbështetur në nenin 179/b, pika 5, të Kushtetutës, nenin F, pikat 1 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 12, datë 23.03.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë. U shpall në Tiranë, më datë 17.07.2018.

RELATORE

Natasha Mulaj

nënshkrimi

ANËTARE

Albana Shtylla

nënshkrimi

KRYESUES

Luan Daci

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol Çomo

nënshkrimi

ANËTAR

Ardian Hajdari

nënshkrimi